

VENDIM
Nr. 955, datë 29.12.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE TË SIGURUAR QË
PËRJASHTOHEN NGA PAGESAT E DREJTPËRDREJTA TË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE¹**

(I shtuar me vendimin nr. 946, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në vendimin nr. 955, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përcaktimin e kategorive të individëve të siguruar që përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta të shërbimeve shëndetësore’”)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 2, dhe 41, të ligjit nr. 10 383, datë 24.1.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përjashtimin nga pagesat e drejtpërdrejta për shërbimet shëndetësore, që janë pjesë e listës së barnave të rimbursueshme, të paketave të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor dhe të kujdesit spitalor që mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, në masën e përcaktuar, për kategoritë e mëposhtme:

- a) Fëmijët 0 - 18 vjeç;
- b) Invalidët e plotë, përfshirë edhe invalidët paraplegjikë, tetraplegjikë dhe të verbrit e plotë;
- c) Invalidët e luftës;
- ç) Veteranët;
- d) Personat që gëzojnë statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë;
- dh) Jetimët;
- e) *Personat që përfitojnë pagesën për aftësinë e kufizuar.*²

2. Përjashtimin nga pagesat e drejtpërdrejta, për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme, për kategoritë e mëposhtme:

- a) Pensionistët;
- b) Personat e paraburgosur dhe të dënuarit me burgim;
- c) Azilkërkuesit;
- ç) Viktimat e trafikimit.

3. *Përjashtimin nga pagesat e drejtpërdrejta për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme për personat që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e parashikuara në*

¹ Shtuar me VKM nr. 946, datë 28.12.2016, të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 264, datë 11 janar 2017;

² Shkronja “e”, shtuar me pikën 1, të VKM nr. 946, datë 28.12.2016, të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 264, datë 11 janar 2017;

pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, për trajtimin e sëmundjeve kronike, sipas listës së miratuar me urdhër të ministrit të Shëndetësisë.³

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.⁴

KRYEMINISTRI

Edi Rama

³ Pika 3, shtuar me pikën 2 të VKM nr. 946, datë 28.12.2016, të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 264, datë 11 janar 2017;

⁴ Përcaktuar me VKM nr. 946, datë 28.12.2016, të botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 264, datë 11 janar 2017.